

VENDIM

Nr.727, date 30.10.2003

PER NJE SHTESE NE VENDIMIN NR.134, DATE 7.3.2003 TE KESHILLIT TE
MINISTRAVE "PER VERTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TE
LESHUARA NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE PER PERDORIM JASHTE VENDIT
DHE DOKUMENTEVE TE HUAJA PER PERDORIM BRENDIA VENDIT"

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te nenit 23 te ligjit nr.8372, date 9.7.1998 "Për
ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike apo konsullore", me
propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Shtetit për Integrim Evropian, Këshilli i
Ministrave

V E N D O S I:

Ne vendimin nr. 134, date 7.3.2003 te Këshillit te Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2.1
me këtë përmbajtje:

"2.1. Nëpunësit konsullore te përfaqësisë se Republikës te Shqipërisë, te akredituar ne Greqi,
te legalizojnë, deri me 30 dhjetor 2003 dokumentet e lëshuara për përdorim jashtë vendit, pa i
vërtetuar sipas pikës 1 te këtij vendimi."

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano